REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 578/23
Datë/Datum. 24.08.23
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSh. nr. 578/2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së OE Grandelite L.L.C., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i shkollës së mesme ekonomike Isa Boletini" me numër të prokurimit 615-23-3422-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E PODUJEVËS, në cilësinë e autoritetit kontraktues, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me datën: 24/08/2023, mori këtë:

VENDIM

1.Hedhet si e palejuar, ankesa e "Grandelite" L.L.C. me Nr. të protokollit 2023/0578, e datës 14/08/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i shkollës së mesme ekonomike Isa Boletini", me numër të prokurimit 615-23-3422-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E PODUJEVËS.

2.Nuk i lejohet, autoritetit kontraktues – KOMUNA E PODUJEVËS që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i shkollës së mesme ekonomike Isa Boletini", me numër të prokurimit 615-23-3422-5-1-1, ngase lidhur me këtë aktivitet është pranuar edhe Ankesa (Nr. Protokolli 581/2023) e cila është në procedurë shqyrtimi OSHP.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik të e-prokurimi me datë 14/08/2023, tek rubrika e ankesave ka pranuar një ankesë nga OE "Grandelite L.L.C.", për aktivitetin e prokurimit me "Ndërtimi i shkollës së mesme ekonomike Isa Boletini", me numër të prokurimit 615-23-3422-5-1-1, inicuar nga KOMUNA E PODUJEVËS në cilësinë e autoriteti kontraktues (AK).

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Zyra e pranimit të ankesave pas pranimit të ankesës, gjatë verifikimit nëse ankesa edhe e dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, nuk ka ofruar dëshminë siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së.

Nisur nga fakti se OE ankesës së lartcekur, nuk i ka bashkangjitur konfirmimin e bankës për tarifën, zyra për pranimin e ankesave përmes sistemit e-prokurimi ka kthyer ankesën për plotësim tek OE-Ankues sipas sistemit elektronik, dhe po ashtu me datën 18.08.2023 përmes email-it e ka njoftuar OE si më lart se i njëjti nuk i ka bashkangjitur formularin për sigurim të depozitës të Ankesës, duke i sqaruar, se i njëjti duhet të ridërgohet e plotësuar me konfirmim të bankës për tarifën e ankesës në fjalë. njëherit ishte njoftuar se nëse nuk vepron sipas udhëzimeve të OSHP ankesa e tij do të hedhet si e palejuar.

Por, edhe përkundër këtij njoftimi dhe sqarimi të OSHP-së, Ankuesi nuk e ka kompletuar ankesën e tij me tarifën e depozitës së sigurimit të ankesës në fjalë. Megjithatë përmes emailit të datës 22/08/2023 ka njoftuar OSHP me arsyetimin si në vijim "për arsyeje te vonesave te ekzekutimit te pagesave nga ana e komunave ku ne kemi projekte ne nuk kemi mundësi te përfundojmë tarifën për pagese, për një gjë te tillë ne si kompani ndjehemi ne pozite shumë te keqe dhe ju kërkojmë falje, mbi te gjitha ne po na pamundësohet edhe mundësi e ankesës sepse ne kemi dorëzuar tenderët dhe kemi plotësuar kushtet mirëpo për arsyeje te njëanshmërisë se AK te K. Podujevës ne jemi eliminuar nga tenderët".

Nga provat e prezantuara vlerësohet se ankesa e parashtruar nga OE "Grandelite L.L.C.", e datës: 14/08/2023 (protokoll 578/2023) për aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës së mesme ekonomike Isa Boletini", me numër të prokurimit 615-23-3422-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E PODUJEVËS konsiderohet si e pa kompletuar sepse ankuesi nuk ka deponuar tarifën e sigurimit të ankesës së tij siç kërkohet në piken 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së lidhur me nenin 118 të LPP-së. Andaj procedura e shqyrtimit të kësaj ankese përfundon në ketë fazë duke e hedhur të njëjtën si jo e plotë ngase kjo ankesë nuk plotëson kushtet për tu proceduar më tutje siç kërkohet dispozitat ligjore të lartcekura.

OSHP, sqaron se lidhur me këtë aktivitet ka në shqyrtim një Ankesën tjetër (Nr. protokolli 581/2023) andaj rrjedhimisht, i ndalohet AK heqja e pezullimit lidhur me këtë aktivitet, deri në njoftimin e OSHP për rastin konkret.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetarja e OSHP-së

Vjosa Gradinaj Mexhuani

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:
1x1 AK KOMUNA E PODUJEVËS
1x1 "Grandelite L.L.C."
.1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së